

VENDIM
Nr. 349, datë 22.11.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 228, DATË 17.7.2023, “MBI PËRCAKTIMIN E SHOQËRISË ‘BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE ALPEX’ SHA, SI OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/14 prot., datë 16.11.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.7.2023, ‘Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 228, datë 17.07.2023 ka vendosur të përcaktojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duke i lënë detyrë në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përkatësisht:

2. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., duhet të depozitojë në ERE Programin Ekonomik të vitit 2023 të ndryshuar të miratuar nga organet drejtuese të saj.

3. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të dokumentojë në ERE informacion mbi arsyet e ndryshimit të organigramës duke shpjeguar detyrat funksionale të personelit.

- ERE, me shkresën me nr. 1395/11 prot., datë 8.8.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 228/2023, duke i sjellë në vëmendje dhe detyrimin për plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1395/12 prot., ERE njoftoi për këtë vendim përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës (AK), Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën e Furnizuesve Shqiptarë të Energjisë Elektrike (AEES), Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA).

- Brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit nr. 228/2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2116 prot., datë 6.9.2023, shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” sh.a., ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, duke plotësuar këto kushte, ndaj këto pika *vlerësohen* të shfuqizohen.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 dhe pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 228/2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX’ sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, shfuqizohen.

2. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti